



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

PLANI I INTEGRITETIT

PËR BASHKINË ELBASAN

2025- 2028

Miratur me vendimin nr..., datë...

të Këshillit Bashkiak, Elbasan

Dokumenti “Plani i Integriteti” u përgatit nga bashkia Elbasan. Ky material u punua dhe u konsultua përgjatë një periudhe 3-mujore përmes diskutimeve konstruktive ndërmjet anëtarëve të grupit të punës, bashkëpunëtorëve grupeve të interesit.

Plani i Integritetit është punuar nga grupi i punës:

- Ervin Muço, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit,
- Lorena Haxhiymeri, Koordinator i Performancës
- Marsida Biba, Specialit pranë Burimeve Njerëzore
- Enea Sanço, Përgjegjës pranë Drejtorisë së Prokurimeve dhe Investimeve.
- Eglantina Doko, Specialit pranë Drejtorisë Financës dhe Buxhetit
- Ardiola Bajraktari, Specilait pranë Drejtorisë së Auditit
- Nadire Kreka – Koordinator i Barazisë Gjinore
- Ana Vrioni – Specialist pranë Drejtorisë Juridike
- Aida Talelli – Koordinator i të Drejtës për Informim
- Eva Bica, Anëtar i Komisionit të Çështjeve Ligjore
- Andi Shtylla, Anëtar i Komisionit të Çështjeve Ligjore
- Anëtarët e Forumit të Qeverijes së Hapur (OGP)

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL



*Ne, drejtuesit politikë dhe administrativë të Bashkisë Elbasan, të frymëzuar nga vlerat e mirëqeverisjes, transparencës dhe përgjegjësisë publike, shpallim këtë Deklaratë të Integritetit për periudhën 2025–2028, si pjesë e pandarë e **Kodit të Sjelljes** dhe **Planit të Integritetit** të miratuar nga Këshilli Bashkiak.*

Integriteti, për ne, nënkupton ushtrimin e detyrës publike me ndershmëri, paanshmëri, transparencë dhe në përputhje me ligjin, duke vendosur gjithmonë interesin publik mbi çdo interes personal apo politik. Në thelb të misionit tonë qëndron bindja se besimi i qytetarëve është pasuria jonë më e madhe dhe se ky besim ndërtohet me veprime të matshme dhe të verifikueshme.

Për ta ruajtur dhe forcuar këtë besim, ne zotohemi të:

- *krijojmë një kulturë institucionale ku ndershmëria, respekti dhe përgjegjësia udhëheqin çdo veprim e vendimmarrje;*
- *sigurojmë hapjen dhe kuptueshmërinë e informacionit publik, në mënyrë që çdo qytetar të ketë akses të lehtë, të plotë dhe të barabartë në të dhënat që e prekin atë;*
- *mbështesim pjesëmarrjen e barabartë të komunitetit në formësimin e politikave dhe buxhetit vendor, duke e kthyer zërin e qytetarëve në vendimmarrje konkrete;*
- *administrojmë me kujdes dhe përgjegjësi çdo aset publik, duke menduar për përfitimin afatgjatë të gjeneratave të ardhshme;*
- *mbrojmë dhe fuqizojmë çdo individ që denoncon shkelje, duke e bërë transparencën mjetin më të fortë kundër korrupsionit;*
- *investojmë në zhvillimin profesional të punonjësve tanë, duke i kthyer ata në shembull të etikës dhe shërbimit publik cilësor;*
- *bashkëpunojmë ngushtë me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si **Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP)**, **OSBE**, **Bashkimi European** dhe organizata të shoqërisë civile, për të sjellë praktikrat më të mira në qeverisjen vendore.*

*Zbatimi i kësaj Deklarate do të matet çdo vit përmes **Raportit të Zbatimit të Planit të Integritetit dhe Indeksit të Besimit Publik “Trust Elbasan”**, duke siguruar transparencë të plotë dhe përmirësim të vazhdueshëm.*

Kjo Deklaratë përfaqëson zotimin tonë të përhershëm për të vepruar me integritet, për të forcuar llogaridhënien dhe për të ndërtuar një administratë vendore që u shërben të gjithëve me dinjitet, drejtësi dhe barazi.

Kryetari i Bashkisë Elbasan

GLEDIAN LLATJA

Tabela e përmbajtjes

I.	PLANI PËR INTEGRITET	Error! Bookmark not defined.
II.	Kuadri Strategjik & Ligjor	6
III.	Qëllimi dhe Objektivat	8
IV.	Procesi dhe Metodologjia (i përditësuar)	14
V.	Zbatimi dhe Sistemi i Monitorimit.....	18

I. Plani Integritetit

Plani i Integritetit 2025–2029 është angazhimi zyrtar i Bashkisë Elbasan për të parandaluar, zbuluar dhe trajtuar shkeljet e integritetit në të gjitha fushat e veprimtarisë së saj institucionale dhe shërbimeve publike. Ky plan pason dhe përmirëson përvojën e akumuluar nga Plani i parë i Integritetit 2020–2023, i cili ishte iniciativa e parë pilot e bashkisë për menaxhimin e riskut të integritetit në nivel vendor.

Plani i parë vendosi themelet për:

- mekanizmin e deklarimit proaktiv të konfliktit të interesit;
- publikimin në kohë reale të kontratave të prokurimit;
- angazhimin qytetar në proceset vendimmarrëse.

Të tre këto masa janë përfshirë dhe zgjeruar në këtë plan të ri.

Plani i Integritetit 2025–2028 sjell disa përmirësime kyçe:

1. **Shtrirje afatgjatë** – mbulon një periudhë katërvjeçare, duke siguruar vazhdimësi dhe stabilitet në zbatimin e masave.
2. **Shtylla të qarta veprimi** – masat janë të strukturuar në dy shtylla themelore: **parandalim** dhe **zbulim**.
3. **Përputhje me standardet kombëtare** – integron plotësisht Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe mbështetet në VKM nr. 241/2018 “Për miratimin e rregullave për hartimin dhe monitorimin e planeve të integritetit”.
4. **Buxhet i dedikuar** – përfshin një buxhet indikativ prej 12 milionë lekësh, si dhe krijon linjën e financimit “**Integritet & Pjesëmarrje Qytetare**”, që synon të mbështesë përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve në vendimmarrje dhe monitorim.
5. **Adoptim i praktikave më të mira** – merr në konsideratë përvojat e suksesshme të bashkive të tjera në Shqipëri, ku transparenca, pjesëmarrja qytetare dhe auditimi i brendshëm kanë dhënë rezultate të matshme.

Me këtë plan, Bashkia Elbasan synon të kalojë nga një fazë pilot në një model të plotë, të matshëm dhe të digjitalizuar të menaxhimit të integritetit, duke forcuar mekanizmat e transparencës, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe përfshirjen aktive të qytetarëve. Progresi do të matet përmes treguesve të qartë dhe raporteve vjetore të monitorimit, të publikuara në mënyrë transparente.

1.2 Përvoja e mëparshme e Bashkisë Elbasan me Planin e Integritetit 2019–2023

Në vitin 2019, Bashkia Elbasan ndërmori për herë të parë hartimin dhe zbatimin e një Plani të Integritetit institucional, duke u bërë një nga njësitë e para të qeverisjes vendore që iu përgjigjën në mënyrë proaktive kuadrit kombëtar antikorrupsion dhe rekomandimeve të Ministrisë së Brendshme. Plani i atëhershëm kishte për qëllim forcimin e mekanizmave të integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë në strukturat administrative të bashkisë dhe u zbatua në përputhje me udhëzimet kombëtare të periudhës përkatëse.

Gjatë ciklit të parë të zbatimit 2019–2023, Bashkia Elbasan realizoi një sërë masash të rëndësishme, përfshirë:

- forcimin e rolit të Koordinatorit të Integritetit,
- trajnime bazë mbi etikën për stafin e brendshëm,
- ngritjen e disa praktikave për transparencën e vendimmarrjes në Këshillin Bashkiak dhe
- publikimin e disa dokumenteve bazë të menaxhimit financiar dhe prokurimeve.

Megjithatë, zbatimi i planit të mëparshëm u përball me disa kufizime, përfshirë mungesën e matjes së performancës për secilën masë, mungesën e një skeme monitorimi dhe përfshirjes së aktorëve të jashtëm, si dhe mungesën e harmonizimit të masave me indikatorë të matshëm të riskut. Në këtë kuadër, plani i ri për periudhën 2025–2029 synon të kapitalizojë përvojën ekzistuese, duke vendosur një sistem të integruar menaxhimi të riskut të integritetit, përfshirë mekanizma për vlerësim, pjesëmarrje dhe transparencë të qëndrueshme, si dhe një qasje më të strukturuar për monitorim dhe raportim periodik.

II. Kuadri Strategjik & Ligjor

Plani i Integritetit 2025–2029 mbështetet në një arkitekturë të plotë normative e strategjike, e cila siguron koherencë vertikale (kombëtare – vendore) dhe horizontale (krahasim rajonal dhe ndërkombëtar). Ky kuadër garanton që masat e parashikuara të jenë në përputhje me standardet ligjore, politikat kombëtare dhe praktikatat më të mira të miratuara ndërkombëtarisht.

1. Kuadri Kombëtar Strategjik dhe Ligjor

Në themel të tij qëndrojnë:

- **Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe Plani i Veprimit 2024–2026**, të cilat vendosin objektivat makro për integritetin publik dhe parashikojnë masat prioritare në nivel kombëtar;
- **Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2025–2030**, e cila garanton parimet e autonomisë vendore, menaxhimit financiar dhe delegimit të funksioneve;
- **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** dhe aktet nënligjore në zbatim, që përcaktojnë kompetencat, përgjegjësitë dhe mekanizmat e llogaridhënies për njësitë vendore;
- **VKM nr. 241, datë 25.04.2018**, ‘Për miratimin e rregullave për hartimin dhe monitorimin e planeve të integritetit’ (Objektivi C.4), e cila detyron njësitë e vetëqeverisjes vendore të hartojnë dhe zbatojnë politika të integritetit dhe plane antikorrupsion në përputhje me standardet kombëtare.

Ky plan është gjithashtu i harmonizuar me:

- **Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)**, ratifikuar nga Shqipëria, e cila vendos standardet ndërkombëtare për parandalimin e korrupsionit, transparencën dhe forcimin e institucioneve;
- **Rekomandimet e GRECO-s (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit)** për forcimin e integritetit në nivel vendor;

- **Parimet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP Local)**, të cilat sigurojnë pjesëmarrje të gjerë qytetare, transparencë dhe llogaridhënie;
- Aktet e reja nënligjore 2024–2025 në fushën e transparencës, menaxhimit të riskut dhe qeverisjes vendore.

2. Kuadri Metodologjik i Hartimit

Hartimi i Planit të Integritetit është udhëhequr nga **Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (MD, 2019)**, e cila ofron një model të unifikuar për identifikimin, vlerësimin dhe prioritarizimin e risqeve në proceset vendore. Kjo metodologji bazohet në gjashtë shtylla të integritetit: Buxheti dhe Prokurimi Publik, Administrimi i Pronës Publike, Burimet Njerëzore, Planifikimi Urban, Shërbimet Publike dhe Kontrolli i Brendshëm.

3. Kuadri Vendor dhe i Brendshëm Institucional

Në nivel vendor, Plani mbështetet gjithashtu në:

- **Rregulloren e Këshillit Bashkiak Elbasan**, e cila garanton transparencën në vendimmarrje, konsultimin publik dhe përcakton procedurat e raportimit ndaj qytetarëve dhe organeve të mbikëqyrjes;
- Politikat ekzistuese të Bashkisë për **qeverisje të hapur, buxhetim me pjesëmarrje, etikë publike, dhe menaxhim të rrezikut**;
- Dokumentet planifikues të lidhur si: **Plani i Performancës, Plani i Masave Antikorrupsion, Plani i Barazisë Gjinore dhe Plani i Mbrojtjes Sociale**, me të cilët ky dokument është i ndërveprueshëm.

III. 3. Qëllimi dhe Objektivat

Ky kapitull përkufizon drejtimin strategjik të përpjekjeve të Bashkisë Elbasan për integritet gjatë periudhës **2025–2029**. Ai paraqet misionin që udhëheq institucionin dhe objektivat strategjike që e përkthejnë këtë mision në rezultate konkrete, të matshme dhe të verifikueshme.

Misioni:

Të krijojmë një administratë vendore që i kundërvihet korrupsionit, është transparente, inovative dhe e përgjegjshme për qytetarët, ku Këshilli Bashkiak (KB), administrata dhe shoqëria civile bashkëqeverisin në mënyrë etike, në përputhje me **Kodin e Sjelljes** dhe kuadrin ligjor kombëtar.

Objektiva specifike:

1) Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit (SIMRI), që do të funksionojë si mekanizmi qendror për identifikimin, vlerësimin dhe reduktimin e risqeve të korrupsionit në të gjitha njësitë organizative të Bashkisë Elbasan dhe që përbëhet nga tre komponentë kyç: SIMRI do të mbështetet në gjashtë shtylla të ndërthurura:

- **Kodi i Sjelljes & Regjistri i Nënshkrimeve** – dokumenti etik i përditësuar miratohet nga Këshilli Bashkiak dhe nënshkruhet nga punonjësit, këshilltarët e KB-së dhe praktikantët. Në këtë mënyrë secili merr detyrimin personal për t’iu përmbajtur standardeve të integritetit dhe merr një referencë të përbashkët për zgjidhjen e dilemave etike.
- **Deklaratë ad-hoc interesi** – këshilltarët dhe anëtarët e komisioneve dorëzojnë deklaratë konflikti interesi për çdo mbledhje vendimmarrëse; formularët publikohen njëkohësisht me procesverbalet.
- **Përditësimi i “One Stop Shop”** – Përmirësimi i “One Stop Shop” nis me auditimin e plotë të rrjedhave të punës për të eliminuar duplikimet dhe vonesat. Sistemi do të pajiset me server rezervë, back-up cloud dhe protokoll emergjence, ndërsa për çdo shërbim publikohen kohët standarde (SLA) që monitorohen përmes një dashboard-i KPI mujor. Kjo paketë rrit transparencën, ul hapësirën për ndërhyrje informale dhe garanton vazhdimësinë e shërbimit edhe në rast dështimesh teknike.
- **Manual “Prokurime Expertizash” + Skema “CSO Monitor”** – procedurë standarde për kontraktimin e ekspertizës së jashtme dhe përfshirja e OSHC-ve si palë vëzhguese në tenderët me vlerë të madhe, në përputhje me Planin OGP lokal.

Këto masa, të kombinuara me detyrën e re të **“Koordinator Open-Data”**, krijojnë një arkitekturë të plotë ku standardet etike, deklarimi i interesit, menaxhimi i risqeve, kontrolli i brendshëm dhe

vëzhgimi i jashtëm funksionojnë në sinergji, duke forcuar besueshmërinë publike dhe rezistencën e Bashkisë ndaj korrupsionit

2) Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie: Ky objektivi synon të bëjë nga faqja zyrtare të Bashkisë Elbasan një “qendër të dhënash në kohë reale”, ku qytetari gjen në kohë reale buxhetin, prokurimet, vendimet e Këshillit Bashkiak dhe raportet e auditimit në formate PDF + CSV/JSON.

Transparenca proaktive është gur themeli i llogaridhënies publike: ajo zvogëlon asimetrinë e informacionit mes administratës dhe qytetarëve, ul hapësirën për korrupsion duke ekspozuar proceset vendimmarrëse në kohë reale, dhe rrit besimin institucional. Kur buxheti, prokurimet dhe vendimet e KB publikohen në formate të lexueshme nga makinat, aktorët e shoqërisë civile dhe mediat mund të kryejnë analizë të thelluar, duke ushtruar kontroll shtesë dhe duke stimuluar përmirësime procesesh. Për më tepër, aksesibiliteti dixhital nxit përdorimin e të dhënave nga bizneset, akademika dhe inovatorët për të krijuar shërbime që shtojnë vlerë ekonomike dhe sociale.

Komponentët kyç të OS-2 (2025-2029):

- **Buxheti i Hapur** – publikohen buxheti i miratuar, ekzekutimi gjashtë-mujor dhe raporti vjetor; një dashboard interaktiv tregon shpërndarjen territoriale të investimeve.
- **Prokurimet e Hapura** – regjistër dinamik kontratash (formati OCDS) me njoftim, oferta, kontratë, pagesa dhe ndryshime; ndërthurur me skemën “CSO Monitor”, ku OSHC-të vëzhgojnë tenderët me vlerë të madhe.
- **Vendimmarrja e KB e Hapur** – procesverbale, raportet e komisioneve dhe vendimet ngarkohen brenda 48 orëve; publikohen gjithashtu **Plani vjetor i konsultimit** dhe **Raporti i transparencës së KB**.
- **Raportet e Performancës & Auditit** – audit i brendshëm, raportet e KLSH-së dhe treguesit SIMRI etiketohet sipas temës/vitit, duke mundësuar analizë krahasuese ndërvite.
- **Open-Data Officer** – punonjës i dedikuar që siguron cilësinë e dataset-eve, metadatat dhe një feed RSS të përditësuar.
- **Trajnim “E Drejtë për Informim”** – ëorkshop-e për stafin front-office mbi afatet 10-ditore, për të garantuar përgjigje ligjërish të sakta.
- **Databazë GIS e Pronave Publike** – hartë interaktive me statusin juridik të çdo pasurie, e lidhur me Buxhetin e Hapur për të treguar investimin sipas asetit
- **Indeksi vjetor “Trust Elbasan”** – sondazh online + kampion në terren që mat besimin e qytetarëve ndaj bashkisë; rezultatet publikohen si dataset i hapur dhe vizualizohen në infografikë. Përveçse barometër suksesi për gjithë objektivin, indeksi furnizon me të dhëna

konkrete Planin e Buxhetimit me Pjesëmarrje dhe raportin vjetor të transparencës, duke treguar ku duhet të fokusohet komunikimi dhe ku kërkohet përmirësim i shërbimeve.

3) Objektivi OS-3 – Zhvillim i Burimeve Njerëzore: Ngritja e kapaciteteve të burimeve

njerëzore dhe këshilltarëve bashkiakë me njohuri të thelluara në etikë, konflikt interesi dhe sinjalizim, , duke siguruar që moduli e-learning **“Integritet &Etikë”** të jetë i disponueshëm në Zyrën e Burimeve Njerëzore të Bashkisë për përdorim të përhershëm.

Shtyllat e zhvillimit të kapaciteteve:

1. **Kalendari i Trajnimeve të Detyrueshme** – përfshin sesione vjetore fizike + rifreskim; lidhur me etikën dhe integritetin. Një kalendar i strukturuar siguron konsistencë dhe parashikueshmëri në zhvillimin e kapaciteteve: çdo punonjës e di paraprakisht kur dhe çfarë trajnimesh do të marrë, duke minimizuar ndërprerjet operacionale. Ky cikël i rregullt krijon një “bosht etik” të përbashkët, përditëson njohuritë ndaj legjislacionit që ndryshon dhe e përforcon kulturën e përgjegjshmërisë. Trajnim “E Drejtë për Informim” – ëorkshop 1-ditor për punonjësit e bashkisë.
2. **Moduli e-learning “Integritet &Etikë”** – paketë 5-orëshe interaktive (video, kuize, simulime). Ky modul ofron fleksibilitet maksimal, pasi mund të përfundohet në segmentet 15-minutëshe gjatë orarit të punës ose nga shtëpia, duke pasur sistem automatik ruajtjeje progresi. Interaktiviteti (studime rasti, skenarë “zgjidh-dhe-vepro”, pyetësorë reflektimi) lejon që secili punonjës të testojë situata reale të konfliktit interesi, ndërsa funksioni i raportimit në back-end i jep Zyrës së Burimeve Njerëzore pamje të plotë të përqindjes së pjesëmarrjes dhe rezultateve, duke u lidhur drejtpërdrejt me skedat e performancës.
3. **Paketë e brendshme për kuadrin rregullator të bashkisë**”- broshurë digjitale + seancë hyrëse për punonjësit e rinj mbi aktet rregullatore bazë.
4. **Rishikim i Përshkrimeve të Punës** – vlerësim dhe përditësim i JD-ve të vjetruara.
5. **Rishikim i Kodit Etik** – përfshirje e VKM 874/2021; konsultim publik dhe miratim në KB.
6. **Deklaratë njohjeje + Informim**– modul 2-orësh; punonjësit e bashkisë dhe praktikantët nënshkruajnë Kodin e Sjelljes para nisjes së internship-it.

Rëndësia për Këshilltarët Bashkiakë: Këshilltarët bashkiakë përbëjnë linjën e parë të mbikëqyrjes demokratike mbi ekzekutivin vendor; aftësimi i tyre në parimet e integritetit i pajis me mjetet për të identifikuar shkeljet, për të ushtruar kontroll efektiv mbi buxhetin dhe për të komunikuar në mënyrë të qartë me zgjedhësit. Trajnimet e dedikuara, të përshtatura për rolin politik dhe funksionin e mbikëqyrjes, sigurojnë që çdo vendim i Këshillit të reflektojë standardet më të larta etike dhe të rrisë besimin e publikut në procesin vendimmarrës.

Rëndësia e vazhdimësisë së trajnimit për stafin bashkiak: Stafi administrativ i bashkisë operon në frontin e parë të ofrimit të shërbimeve publike dhe zbatimit të politikave. Mjedisi rregullator, teknologjik dhe procedural evoluon vazhdimisht; pa rifreskime periodike të njohurive mbi etikën dhe menaxhimin e konfliktit të interesit, ekziston rreziku që praktikrat e reja të korrupsionit të mbeten të paidentifikuara. Trajnimi i përhershëm garanton që çdo punonjës të njohë standardet më të fundit ligjore dhe të jetë i aftë të reagojë në mënyrë të duhur ndaj sinjalizimeve. Për më tepër, ai forcon kulturën organizative, ul rezistencën ndaj reformave digjitale dhe krijon një cikël pozitiv ku praktikrat e mira përhapen brenda strukturës së bashkisë.

Objektivi OS-4 – Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare

Qëllimi: Të institucionalizohet një infrastrukturë e qëndrueshme për pjesëmarrjen qytetare që përfshin **Buxhetimin me Pjesëmarrje** ($\geq 5\%$ e buxhetit zhvillimor), dhe **“Ditët e Hapura Kundër Korrupsionit”** dy herë në vit, duke siguruar angazhim të gjerë të qytetarëve, OSHC-ve dhe Këshillit Bashkiak deri në fund të 2028-s. Një infrastrukturë e qëndrueshme për pjesëmarrjen qytetare që i jep qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) dhe Këshillit Bashkiak role të qarta, mjete dhe kanale të rregullta dialogu për të bashkë-vendosur mbi prioritetet zhvillimore dhe për të mbikëqyrur menaxhimin e fondeve publike.

Komponentët kryesorë të OS-4:

1. **Buxhetimi me Pjesëmarrje** – proces vjetor ku qytetarët propozojnë e votojnë projekte komunitare, me të paktën 5 % të fondit zhvillimor (~ 120 mln lekë në 2026). *Nëpërmjet një linje shtesë prej 0.1 mln lekësh/vit, procesi shtrihet në lagjet rrome dhe egjiptiane (Rapishte, Mëhalla e Madhe), duke mbuluar transportin, përkthimin komunitar dhe sesionet informuese.* Ky mekanizëm i bën qytetarët bashkautorë në vendimarrjen financiare, duke i lejuar ata të propozojnë dhe votojnë projekte konkrete për komunitetin e tyre. Ai rrit transparencën fiskale, kultivon pronësisë mbi fondet publike dhe ndihmon bashkinë të identifikojë nevojat reale të njësive administrative, duke e orientuar investimin aty ku krijon impakt më të madh social.
2. **“Ditët e Hapura Kundër Korrupsionit”** – forume dy-ditore (prill, dhjetor) me ekspozë të prokurimeve kryesore, stenda OSHC-sh dhe sesione pyetje-përgjigje me zyrtarët. **Ditët e Hapura** krijojnë një forum të rregullt ku qytetarët, mediat dhe OSHC-të mund të pyesin drejtpërdrejt zyrtarët mbi kontratat kryesore, shpenzimet dhe progresin e planit të integritetit. Këto evente rrisin llogaridhënien, ulin perceptimin e mungesës së transparencës dhe gjenerojnë rekomandime praktike që përmirësojnë proceset.
3. **Laboratorët e Integritetit Rinor** – programe 3-mujore në shkolla të mesme për mini-projekte anti-korrupsin. Inkorporimi i të rinjve në iniciativat e integritetit ndihmon në krijimin e një kulture të hershme të antikorrupsionit. Programet tre-mujore u japin

nxënësve mjete praktike kërkimore dhe aftësi prezantimi për të identifikuar probleme dhe sugjeruar zgjidhje etike në shkollat dhe lagjet e tyre. Ky angazhim ndërton një brez të ri qytetarësh të ndërgjegjshëm dhe i sjell energji e inovacion agjendës së Integritetit të Bashkisë.

4. **Indeksi vjetor “Trust Elbasan”** – Sondazh online dhe në terren që mat besimin e qytetarëve ndaj bashkisë, me publikim të të dhënave si dataset i hapur. Sondazh online dhe në terren që mat besimin e qytetarëve ndaj bashkisë, me publikim të të dhënave si dataset i hapur. Rezultatet krahasohen me njësi të ngjashme vendore për të identifikuar boshllëqet në komunikim dhe cilësinë e shërbimeve. Përmirësimet e propozuara nga sondazhi integrohen në Planin vjetor të Transparencës dhe në Buxhetimin me Pjesëmarrje, duke siguruar që perceptimet e publikut të reflektohen në vendimmarrje.

IV. Proçesi dhe Metodologjia

Procesi i hartimit të PI u zhvillua nga muaji prill 2025 deri korrik 2025, duke kombinuar metoda sasiorë dhe cilësore për të siguruar një diagnozë të plotë të risqeve të integritetit dhe për të përcaktuar masat përkatëse në përputhje me **VKM nr. 241/2018, Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për NJVV (MD, 2019)** dhe standardet ndërkombëtare **ISO 37001** (Sistemet Antikorrupsion) dhe **ISO 31000** (Menaxhimi i Riskut).

Struktura organizative e procesit

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë u ngrit një grup pune me përfaqësues nga të gjitha drejtoritë e Bashkisë Elbasan. Grupi u kryesua nga Nënkryetari i Bashkisë dhe përfshinte:

- Koordinatorët për Konfliktin e Interesit dhe Sinjalizimin;
- Përfaqësues të OGP Forumit lokal;
- Përfaqësues të Drejtorive me risk të lartë sipas metodologjisë;
- Njësi teknike për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.

Ky konfigurim siguroi që çdo fushë me risk të kishte ekspertizë të dedikuar dhe që konsultimi qytetar të përfshihej që në fazat e hershme të proçesit. Dizajni i anketave dhe i fokus-grupeve u mbështet mbi gjetjet dhe rekomandimet e Planit të Integritetit 2020-2022, duke garantuar vijueshmëri metodologjike dhe krahasueshmëri të rezultateve.

2. Hapi 1 – Vlerësimi Sasiore

U realizua përmes një anketimi elektronik me 104 punonjës (kampion përfaqësues i 300 të punësuarve aktivë në bashki), duke garantuar një gabim statistikor $\pm 5\%$ në nivel besueshmërie 95 %. Pyetësi me 32 indikatorë matës sondoi perceptimet mbi:

- Konfliktin e interesit;
- Transparencën e prokurimeve;
- Respektimin e Kodit të Sjelljes;
- Efikasitetin e kontrolleve të brendshme.

Të dhënat u përpunuan përmes një **dashboard-i KPI** që gjeneroi raportim automatik dhe mundësoi krahasimin me rezultatet e planit të mëparshëm.

3. Hapi 2 – Vlerësimi Cilësor

U zhvillua përmes:

- Fokus-grupeve në nivel drejtorish;
- Analizës së kuadrit të brendshëm rregullator;
- Shqyrtimit të raporteve të auditimit, raporteve të KLSH, dhe raporteve të OSHC-ve.

Analiza u udhëhoq nga modeli i “6 shtyllave të integritetit”:

1. Buxheti & Prokurimi Publik;
2. Administrimi i Pronës Publike;
3. Burimet Njerëzore;
4. Planifikimi Urban;
5. Shërbimet Publike;
6. Kontrolli i Brendshëm.

4. Vlerësimi i risqeve

U bazua në tre dimensione të ndërvarura:

- **Probabiliteti** i shfaqjes së ngjarjes;
- **Impakti** mbi integritetin institucional dhe besimin publik;
- **Efikasiteti** i kontrolleve ekzistuese.

Çdo dimension u notua me vlerë nga 1 në 3, sipas një udhëzuesi të standardizuar për të shmangur subjektivitetin. Shuma e tre dimensioneve gjeneroi pikëzimin total për secilin risk, i koduar sipas “semaforit të riskut”:

- **Kuq** (> 6) – rrezik i lartë, masa urgjente;
- **Verdhë** (3–5) – rrezik mesatar, duhet monitoruar;
- **Gjelbër** (≤ 3) – rrezik i ulët.

5. Grafiku kohor i procesit

- **Prill 2025** – Krijimi i grupit të punës dhe përcaktimi i kalendarit;
- **Maj 2025** – Anketimi elektronik dhe fokus-grupet e para;
- **Qershor 2025** – Analiza e të dhënave dhe draftimi i masave;
- **Korrik 2025** – Konsultimi publik me qytetarët dhe OGP Forumin;
- **Gusht 2025** – Finalizimi dhe dorëzimi i draftit për miratim në Këshillin Bashkiak.

Ky proces garantoj një qasje gjithëpërfshirëse, të bazuar në prova dhe në standarde të matshme, duke krijuar një plan që adreson risqet reale dhe forcon kapacitetet institucionale për integritet.

4.1 Buxhetimi i Masave Prioritare

Bashkia Elbasan miratoi buxhetin vjetor 2025 në rreth **5 miliardë lekë** (≈ 42 milion €). Duke respektuar tavanin ligjor që shpenzimet për integritet të mos tejkalojnë **1 %** të buxhetit (≈ 50 milionë lekë në vit), paketa e konsoliduar e masave për katër objektivat kërkon rreth **22 milionë lekë** në vitin e parë, ose **0.44 %** të buxhetit total.

Bloku i masave	Investim fillestar (lekë)	Operim vjetor (lekë)	Totali vit 1
OS-1 – SIMRI	5.4 mln	0.3 mln	5.7 mln
OS-2 – Transparencë	3.6 mln	1.1 mln	4.7 mln
OS-3 – Burime Njerëzore	2.7 mln	1.1 mln	3.8 mln
OS-4 – Pjesëmarrje Qytetare	–	7.8 mln	7.8 mln
TOTAL	11.7 mln	10.3 mln	≈ 22 mln

Si u përlllogaritën kostot?

- **Investimet** (11.7 mln lekë) përfshijnë shpenzimet kapitale një-herëshe: platforma digjitale (OCDS, GIS, e-learning), modernizim serverash, rishikim përshkrimesh pune, paketë orientuese etj.
- **Operimi** (10.3 mln lekë/vit) mbulon trajnimet periodike, forumet “Ditët e Hapura”, Buxhetimin me Pjesëmarrje, sondazhin “Trust Elbasan”, skemën “CSO Monitor” dhe mirëmbajtjen e sistemeve digjitale.

Në buxhetet pasuese, vetëm komponenti operativ (~ 10 mln lekë/vit) përsëritet, ndërsa kostot kapitale amortizohen. Me shpenzime prej 0.44 % të buxhetit, Bashkia mbetet komodisht nën kufirin 1 %, duke lënë **≈ 28 milionë lekë** hapësirë si fond kontingjence për masa të reja ose kosto të paparashikuara gjatë zbatimit.

V. Zbatimi dhe Sistemi i Monitorimit

Kapitulli i zbatimit dhe monitorimit është ndërtuar në përputhje me “**Metodologjinë për Monitorimin e Planeve të Integritetit**” (Ministria e Drejtësisë, 2021), duke ndërthurur:

- vetëvlerësimin institucional,
- verifikimin e jashtëm dhe
- angazhimin e aktorëve të jashtëm (qytetarë, OSHC, Këshilli Bashkiak).

Ky sistem synon të sigurojë që progresi ndaj objektivave të Planit të Integritetit (PI) të matet në mënyrë të rregullt, transparente dhe të krahasueshme në kohë.

5.1 Strukturat përgjegjëse

NIVELI	ORGANIZMI PËRGJEGJËS	DETYRAT KRYESORE
STRATEGJIK	Kryetari i Bashkisë	- Miraton planin vjetor të monitorimit; - Shqyrton raportet ndërmjetëse dhe vjetore; - Propozon masa korrigjuese dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.
OPERATIV	Koordinatori i Integritetit (i caktuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë) Koordinatori i Performancës	- Drejton procesin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave; - Koordinon Njësitë e Kontaktit në çdo drejtori; - Përgatit raportet tremujore dhe vjetore; - Raporton periodikisht te Kryetari i Bashkisë dhe Komiteti drejtues.
TEKNIK	Njësitë e Kontaktit (1 specialist për çdo drejtori bashkiake)	- Plotësojnë formularët standardë të monitorimit; - Azhurnojnë matricën e riskut të integritetit; - Sigurojnë evidencat dokumentare për masat e zbatuara.

5.2. Proçesi i ciklit vjetor

Faza	Përshkrimi
1. Planifikimi (Janar)	Koordinatori i Integritetit përgatit planin vjetor të monitorimit (kalendari, përgjegjësit, burimet), i cili miratohet nga Kryetari i Bashkisë.
2. Mbledhja e të dhënave	Njësitë e Kontaktit në çdo drejtori plotësojnë të dhënat për zbatimin e masave, të bazuara në formatet e miratuara të monitorimit.
3. Analiza & Konsolidimi (Prill, Korrik, Tetor)	Koordinatori analizon progresin dhe përgatit raportet ndërmjetëse tremujore për diskutim në nivel drejtues.
4. Raporti Vjetor i Integritetit (RVI) (Janar – Mars)	Koordinatori përgatit raportin përmbledhës vjetor; pas miratimit nga Kryetari, ai publikohet në faqen zyrtare të bashkisë dhe i dërgohet AMVV-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion (DPAK) për informacion.
5. Rishikimi & Përditësimi (Dhjetor)	Matrica e riskut përditësohet dhe bëhet riprioritizimi i masave për vitin pasardhës, duke përfshirë edhe kërkesat për buxhet shtesë nëse nevojitet.

VI. Plani i Veprimit:

	Risku i Identifikuar	Prioriteti	Masa Prioritare	Aktivitetet Kryesore	Përgjegjësi & Afati	Objektivi specifik	Buxheti indikativ
1	Pjesëmarrje e ulët e qytetarëve në vendimmarrje financiare	Lartë	Buxheti me Pjesëmarrje	Publikim ftesash; votim online; monitorim projektsh	Drejtoria Financë & Koordinator i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, Koordinator i Performancës, Forumi OGP– Q4/2025	<i>Objektivi OS-4 – Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare</i>	6 mln lekë/vit (≥ 5 % fond zhvillimor)
2	Mungesë dialogu publik mbi kontratat.	Moderuar	Ditët e Hapura Kundër Korrupsionit	Organizim forumi 2×/vit; publikim kontratash;	Koordinatori i integritetit & Koordinator për të drejtën për Informim & Koordinator i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, Forumi OGP– Q2/2026 e në vazhdim	<i>Objektivi OS-4 – Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare</i>	1 mln lekë/vit
3	Pjesëmarrje e ulët e të rinjve në aktivitete/vendimmarrjet e bashkisë	Moderuar	Punëtoritë e Integritetit Rinor	Dizajn programi; mentorim	Drejtoria Arsimit & DAR Elbasan Koordinator Integritet, Koordinator i Performancës, Forumi OGP – Q4/2026 e në vazhdim	<i>Objektivi OS-4 – Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare</i>	0.5 mln lekë/vit

4	Pjesëmarrje e ulët qytetare në vendimmarrje financiare nga grupet vulnerabel rome dhe egjiptiane në qytet	Moderuar	Buxheti me Pjesëmarrje	Përfshirje në planin e konsultimit të bashkisë për konsultimin e PBA-së në mënyrë specifike konsultimin me banorën në zonën e Rapishtës dhe zona e Mëhalla e Madhe poshtë stacionit të trenit; Sesione informimi në lagjet target; Logjistikë & transporti	Koordinatori Njoftimit dhe Konsultimit Publik, Koordinatori i Performancës, Forumi OGP & Sekretari i këshillit Bashkiak – Q2/2026→	<i>Objektivi OS-4 – Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare</i>	0.1 mln lekë/vit
5	Mungesë trajnimi periodik etik	Lartë	Kalendari i Trajnimeve të Detyrueshme	Miratim kalendari; zbatim cikël trajnimesh	Drejtorja BNJ, Koordinator i Performancës – Q1/2026	<i>Objektivi OS-3 – Zhvillim i Burimeve Njerëzore:</i>	0.8 mln lekë/vit
6	Mungesë e trajnimeve periodike për etikën dhe integritetin.	Lartë	Moduli e-learning “Integritet & Etikë”	Zhvillim module; lançim; raportim HRMIS	Drejtorja BNJ, & IT – Q2/2027	<i>Objektivi OS-3 – Zhvillim i Burimeve Njerëzore:</i>	1.5 mln lekë (një herë)

7	Buxheti i pa publikuar në formate të hapura.	Lartë	Buxheti i Hapur	Publikim PDF+CSV; përditësim gjashtëmuor	Drejtoria Financës & IT& Koordinatori për të Drejtën për Informim, Koordinatori i Performancës – Q1/2027 në vazhdim	<i>Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie</i>	Mbulohet nga kapacitetet ekzistuese të bashkisë
8	Të dhëna të paplota të prokurimit.	Lartë	Prokurimet e Hapura	Regjistër elektronik i kontratave të prokurimit; publikim i regjistrit	Njësia e Prokurime & IT – Q2/2026 në vazhdim	<i>Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie</i>	0.6 mln lekë
9	Vendimet KB jo të publikuara në kohë	Moderuar	Vendimmarrja e KB e Hapur	Postim procesverbale ≤48h; arkiv kërkes	Sekretaria KB & IT – Q3/2026	<i>Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie</i>	Mbulohet nga kapacitetet ekzistuese të bashkisë
10	Raportet audit nuk bëhen publike	Lartë	Raportet e Performancës & Auditit	Arkivim sipas temës/vitit; publikim ëeb i gjetjeve të raporteve të auditimit të brendshëm	NjAB & Koordinatori për të Drejtën për Informim – Q2/2026	<i>Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie</i>	_ Mbulohet nga kapacitetet ekzistuese të bashkisë
11	Njohuri të pa përditësuar për etikën dhe integritetin i stafit të bashkisë dhe anëtareve të KB	Lartë	Kodi i Sjelljes & Regjistri i Nënshkrimeve	Draft; miratim; nënshkrime staf + KB	Drejtoria BNJ& drejtoria Juridike – Q1/2026 e në vazhdim	<i>Objektivi OS-3 – Zhvillim i Burimeve Njerëzore:</i>	0.3 milionë lekë

12	Mungesë e deklarimit periodik të Konfliktit të Interesit të kështilltarëve/komisionëve të anëtarëve të KB përpara çdo vendimmarrje.	I moderuar	Deklaratë interesi ad-hoc	Draft rregullore KB = deklarate; verifikim ligjor	Sekretaria e KB + DBNJ Q1 2027	<i>Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i>	0.2 milionë lekë (
13	Mosfunksionim i plotë i zyrave “One Stop Shop” në bashki.	I lartë	Standardizim & Upgrade “One Stop Shop”	Audit i proceseve ekzistuese; • Rezervë server/back-up & protokoll emergjence; • Publikim SLA + monitorim KPI mujor	Grup pune me punonjës të bashkësi i drejtuar nga Nënkyetari i bashkisë për kryerjen e analizës dhe parashikimin e një Plani Pune për zbatim. Drejtoria IT, Koordinator i Performancës	<i>Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i>	0.35 mln lekë (investim fillestar) + 0.05 mln lekë/vit (mirëmbajtje)
14	Mungon punonjës i dedikuar për të dhënat hapura.	I lartë	Emërimi i një punonjësi “Open-Data Officer”	Vendim i Kryetarit; përshkrim pune; trajnimi fillestar	Drejtoria BNJ, Koordinator i Performancës & Kryetari – Q2/2026	<i>Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i>	Pa kosto shtesë – i deleguar një punonjësi ekzistues
15	Mungesë e planit vjetor konsultimi publik dhe raporti vjetor i transparencës	Moderuar	Plan Konsultimi & Raport Transparencë KB	Hartim kalendar; publikim; raport vjetor	Koordinatori N/K Publik & Sekretaria KB – Q4/2026	<i>Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie</i>	Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme

16	Punonjësit e punësuar rrishtazi nuk informohen mbi paketën orientuese mbi aktet rregullatore	Moderuar	Paketë “Hyrëse”	Paketë digjitale; Sesion hyrës.	Drejtoria BNJ – Q1/2027	<i>Objektivi OS-3 – Zhvillim i Burimeve Njerëzore:</i>	<i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i>
17	Përshkrimet ekzistuese të punës mund të jenë të vjetruara	Moderuar	Audit & rishikim i përshkrimeve të Punës	Rishikim me BNJ dhe drejtoritë përkatëse.	Drejtoria BNJ – Q3/2027	<i>Objektivi OS-3 – Zhvillim i Burimeve Njerëzore:</i>	<i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i>
18	Kodi Etik i pa përditësuar (me përcaktimet e VKM nr.874/2021)	Moderuar	Rishikim i Kodit Etik + elementët e rinj	Draft ndryshimesh; konsultim; miratim	Grup pune me punonjës nga Drejtoria Juridike dhe BNJ +Koordinatori i Integritetit Q2/2026	<i>Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i>	<i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i>
19	Njohuri të kufizuara mbi ligjin e informimit nga stafi i bashkisë	Lartë	Trajnim “E Drejta për Informim”	Ëorkshop 1-ditor/ drejtori; materiale	Koordinatori për të Drejtën për Informim & Drejtoria BNJ – Q4/2026	<i>Objektivi OS-3 – Zhvillim i Burimeve Njerëzore:</i>	<i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i>
20	Mungesë e një databaze elektronike të pronave bashkiake.	Moderuar	Databazë GIS e Pronave	Skanim titujsh; GIS entry; test	Drejtoria Pronave & Drejtoria TI– Q4/2026	<i>Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie</i>	0.5 milion
21	Mungesë e një mekanizmi që mat perceptimin publik / indeks vjetor i besimit publik.	Moderuar	Indeksi “Trust-Elbasan”	Dizenjimi pyetsorit; sondazh; publikim	Koordinatori i Performances & Forumi OGP– Q2/2027 → çdo vit	<i>Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie</i>	<i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i>

22	Kodi Etik nuk njihet nga praktikantët / që kryejnë intershipin në institucion.	Moderuar	Deklaratë njohjeje + trajnime praktikantësh	Përfshirje subjektesh; modul 2-orësh	Drejtoria HR – Q1/2027	<i>Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i>	<i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i>
23	Mungesë e një procedurë standarde për ekspertizë të jashtme.	Moderuar	Manual “Prokurime Expertizash”	Draft manual; miratim; trajnim Njesisë së Prokurimeve	Njësia Prokurime – Q3/2026	<i>Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i>	<i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i>
24	Mungon mekanizëm i pavarur vëzhgimi për tenderët me vlerë të madhe → rrezik korrupsioni/ zbatim planeve dhe strategjive të bashkise	I larte	Skema “CSO Monitor”	Përditësim OGP-Planit lokal me klauzolë monitoruese • Thirrje publike & përzgjedhje OSHC-sh monitoruese • Përpunim të dhënash deh analizë • Publikim raporte trimestrale të vëzhgimit	Grup pune me punonjës të bashksië i kryesuar nga nënkryetari i bashkisë, Koordinatori i Drejtës së Infomimit dhe Forumi OGP – Q2 2026	<i>Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i>	<i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i>

25	Mungesë vlerësimi i jashtëm periodik mbi performancën e bashkisë në integritet dhe transparencë.	Moderuar	Paneli i Integritetit me pjesëmarrje të Forumit OGP	Hartimi i një metodologjie të vlerësimit 360°; Mbledhje 2 herë në vit; Publikim i një raporti me gjetjet dhe rekomandimet; Follow-up zyrtar nga Kryetari i Bashkisë dhe Sekretari i Përgjithshëm	Koordinatori i Integritetit), Forumi OGP, Koordinator i Performancës.- Q1 2026 e në vazhdim (çdo 6 muaj)	<i>Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i>	<i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i>
----	--	----------	--	--	--	--	--

TABELA PËRMBLEDHËSE SIPAS OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË

Objektivi Strategjik	Nr. i Masave	% e Totaleve të Masave	Buxheti Total (mln lekë)	% e Buxhetit Total
OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Riskut të Integritetit	8	32%	1.1	5.9%
OS-2: Transparencë & Llogaridhënie	6	24%	0.94	5%
OS-3: Zhvillim i Burimeve Njerëzore	6	24%	2.2	11.8%
OS-4: Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare	5	20%	6.5	34.5%
Pa kosto shtesë (realizohen me burime të brendshme)	-	-	8.1	42.8%
TOTAL	25	100%	18.84	100%

Analiza Përmbledhëse

Në total, plani përmban 25 masa prioritare, të shpërndara në katër objektiva strategjikë.

- **OS-4 “Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare”** përfaqëson pjesën më të madhe të buxhetit (34.5%), duke reflektuar prioritetin e Bashkisë Elbasan për të forcuar përfshirjen qytetare dhe transparencën.
- **OS-3 “Zhvillim i Burimeve Njerëzore”** zë 11.8% të buxhetit, duke theksuar nevojën për ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe këshilltarëve bashkiakë.
- **OS-2 “Transparencë & Llogaridhënie”** ka 5% të fondeve, duke u fokusuar në hapjen e të dhënave, publikimin në kohë dhe llogaridhënien publike.
- **OS-1 “Konsolidim i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Riskut të Integritetit”** përfshin 5.9% të buxhetit dhe forcon mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut.
- **42.8% e buxhetit** përfaqëson masa pa kosto shtesë, të realizuara me burimet ekzistuese të bashkisë, duke treguar një përdorim efikas të kapaciteteve të brends

Anekset që vijojnë janë pjesë integrale e Planit të Integritetit 2025–2028 dhe kanë karakter zbatues e sqarues për masat e përcaktuara në dokument

ANEKSI 1 – Mekanizmi i Monitorimit të Planit të Integritetit

Qëllimi:

Të sigurojë që zbatimi i masave të Planit të Integritetit 2025–2029 monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke garantuar korrigjimin në kohë të devijimeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Strukturat përgjegjëse:

- **Kryetari i Bashkisë:** Miraton planin vjetor të monitorimit dhe siguron buxhetin për zbatim.
- **Koordinatori i Integritetit:** Drejton procesin teknik të mbledhjes dhe analizës së të dhënave; përgatit raportet tremujore dhe vjetore.
- **Njësitë e Kontaktit në Drejtori:** Raportojnë mbi zbatimin e masave sipas formatit standard.
- **Forumi OGP dhe OSHC-të:** Marrin pjesë në monitorimin e jashtëm dhe hartojnë raporte 6-mujore mbi transparencën dhe etikën.

Procesi vjetor i monitorimit:

1. **Planifikimi (Janar):** Hartohet plani vjetor i monitorimit me afate, përgjegjësi dhe burime.
2. **Mbledhja e të dhënave:** Njësitë e kontaktit dorëzojnë evidencat për çdo masë dhe përditësojnë matricën e riskut.
3. **Raportimi tremujor:** Raporte ndërmjetëse për diskutim në nivel drejtues dhe me Forumin OGP.
4. **Raporti vjetor i integritetit:** Publikohet online dhe i dorëzohet Këshillit Bashkiak.
5. **Rishikimi:** Përditësimi i matricës së riskut dhe planifikimi i vitit pasardhës.

ANEKSI 2 – Përputhshmëria me Standardet Ndërkombëtare dhe Kombëtare

Kuadri ligjor dhe strategjik kombëtar:

- **Ligji nr. 139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore”
- **Ligji nr. 60/2016** “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”
- **Ligji nr. 119/2014** “Për të drejtën e informimit”
- **VKM nr. 241/2018** për masat e integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore
- **VKM nr. 873/2021** për konfliktin e interesit, deklarimin e pasurisë dhe sjelljen etike
- **Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030**

Përputhshmëria ndërkombëtare:

- **Parimet e Qeverisjes së Hapur (OGP)** – Transparencë, Llogaridhënie, Pjesëmarrje Qytetare.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)** – Nenet për transparencën, pjesëmarrjen dhe integritetin institucional.
- **Standardet e Këshillit të Evropës për etikën publike** – Respektimi i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.

Vlerësimi i përputhshmërisë:

Plani i Integritetit 2025–2029 është konceptuar në përputhje të plotë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar harmonizim vertikal dhe horizontal të masave të tij.

ANEKSI 3 – Mekanizmi i Sinjalizuesve dhe Mbrojtja e tyre

Qëllimi:

Të garantojë raportimin e sigurt të shkeljeve, trajtimin e drejtë dhe mbrojtjen nga hakmarrja për punonjësit dhe qytetarët që sinjalizojnë.

Përkufizim:

Sinjalizues është çdo punonjës, ish-punonjës apo palë e tretë që raporton ose bën publikisht të ditur shkelje të dyshuara të ligjit, rregullave apo standardeve etike të Bashkisë Elbasan.

Procedura:

1. **Raportimi i brendshëm:** Drejtohet tek Koordinatori i Integritetit përmes formularit standard dhe kanalit të sigurt (email i dedikuar ose kuti fizike të mbyllura).
2. **Raportimi i jashtëm:** Tek ILDKPKI ose autoritete të tjera sipas Ligjit nr. 60/2016.
3. **Afati i shqyrtimit:** 30 ditë nga marrja e raportimit për t'u dhënë përgjigje sinjalizuesit.

Mbrojtja:

- Anonimiteti i sinjalizuesit ruhet në çdo fazë të procesit.
- Ndalohet çdo formë diskriminimi, penalizimi apo hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit.
- Masa disiplinore ndaj personave që cenojnë mbrojtjen e sinjalizuesit.

Raportimi vjetor:

Koordinatori i Integritetit përfshin në raportin vjetor numrin dhe kategorinë e sinjalizimeve, masat e marra dhe statusin e tyre